



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KRUIJË

Nr. 1505 Prot

Datë 19 . 10 .2024

**SHPALLJE PËR APLIKIM SI MËSUES KOORDINATOR TË KËSHILLIMIT TË
KARRIERËS DHE MËSUES KOORDINATOR TË SIGURIMIT TË CILËSISË**

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 27.2.2019, "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar" i ndryshuar, Urdhërit Nr. 463, datë 30.08.2024, "Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e "Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë" dhe të "Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, shkresës Nr. 5367/3 prot., datë 04.09.2024, "Mbi zbatimin Urdhërit Nr. 463, datë 30.08.2024 "Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e "Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë" dhe të "Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës" në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe shkresës nr 2946/1 dt 18.09.2024, të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, mbi numrin e miratuar të mësuesve koordinatorë për sigurimin e cilësisë dhe mësuesve koordinatorë të këshillimit të karrierës

Ju njoftojmë se shpallen procedurat e konkurrimit të mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për mësues koordinator për sigurimin e cilësisë:

- Duhet të jetë pjesë e sistemit arsimor me kontratë pa afat dhe të ketë 8 vite punë si mësues, nga të cilat 5 vite në shkollën ku punon dhe aplikon për mësues koordinator të sigurimit të cilësisë ose në shkollën me numër më të madh nxënësish.**
- Të ketë kategorinë "Mësues specialist" me rezultat "Shumë mire" ose "Shkëlqyeshëm". Avantazh përbën rezultati "Shkëlqyeshëm".**
- Të jetë vlerësuar në matjen e performancës vjetore të mësuesit me vlerësimin "Shumë mire" për tri vite radhazi.**
- Të ketë kryer prezantimin e një projekti novator për zhvillimin e lëndës, që dëshmohet nga institucioni arsimor përkatës.**
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe aftësi shumë të mira kompjuterike.**

Dokumentacioni që duhet të dorëzojë:

- Kërkesë me shkrim,**
- Jetëshkrim,**

- c) Kopje të diplomave dhe listës së notave,
- d) Librezë pune ose vërtetim pune,
- e) Kopje të certifikatës së kualifikimit të fundit,
- f) Vlerësimet e punës së tre viteve të fundit,
- g) Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj (anglisht),
- h) Çertifikatë apo dëshmi të njohurive të programeve kryesore kompjuterike,
- i) Prezantimi i projektit novator për zhvillimin e lëndës, që dëshmohet nga institucioni arsimor përkatës,
- j) Certifikata, trajnime ose rekomandime që dëshmojnë njohuri në fushën e aktiviteteve që mbështesin zhvillimin e talenteve të nxënësve,
- k) Deklaratë për vërtetësinë e dokumentave,
- l) Deklaratë e konfliktit të interesit,
- m) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për mësues koordinator për këshillimin e karrierës:

- a) Duhet të jetë pjesë e sistemit arsimor dhe të ketë 5 vite punë si mësues, ndër të cilat 3 vite si mësues në shkollën ku punon dhe aplikon për mësues koordinator të këshillimit të karrierës ose në shkollën me numër më të madh nxënësish.
- b) Të ketë përfituar kategorinë “Mësues i kualifikuar” me rezultat “Shumë mire” ose “Shkëlqyeshëm”. Avantazh përbën rezultati “Shkëlqyeshëm”.
- c) Të jetë vlerësuar në matjen e performancës vjetore të mësuesit me vlerësimin “Shumë mire” për dy vite radhazi.
- d) Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe njohuri në fushën e aktiviteteve që mbështesin zhvillimin e talenteve të nxënësve, të cituara në vlerësimet periodike të mësuesit në shkollë apo certifikata në trajnime.
- e) Të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe aftësi shumë të mira kompjuterike.

Dokumentacioni që duhet të dorëzojë:

- a) Kërkesë me shkrim,
- b) Jetëshkrim,
- c) Kopje të diplomave dhe listës së notave,
- d) Librezë pune ose vërtetim pune,
- e) Kopje të certifikatës së kualifikimit të fundit,
- f) Vlerësimet e punës së dy viteve të fundit,
- g) Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj (anglisht),
- h) Çertifikatë apo dëshmi të njohurive të programeve kryesore kompjuterike,
- i) Certifikata, trajnime ose rekomandime që dëshmojnë njohuri në fushën e aktiviteteve që mbështesin zhvillimin e talenteve të nxënësve,
- j) Deklaratë për vërtetësinë e dokumentave,

- k) Deklaratë e konfliktit të interesit,
- l) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.

Në rast se nuk paraqiten aplikime që përmbushin pikën 14 të këtij urdhri dhe/ose aplikantë që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë urdhër, për këto pozicione mund të aplikojnë mësuës me kontratë pune me afat të pacaktuar nën juridiksionin e ZVAP – së përkatëse, në varësi të ngarkesës së tyre mësimore pa cenuar planin lëndor përkatës.

Aplikimet për këto dy pozicione bëhen prej datës 14.09.2024 deri 24.10.2024.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dosjen me elementët e detyrueshëm në ZVAP Krujë.

Bashkelidhur vendet.

DREJTOR

DORINA LACI



DRAP	ZVAP	NUMRI I KORDINATOR DHE KARRIERE	SHKOLLA EMEROHET	KU	LLOJI SHKOLLES	SHKOLLAT QE MBULON	NR. NX. SHKOLLE	CDO	NR. NX. TOTAL
Dures	Kruje	1 karriere	Adem Gjeli		9 vjecare	Adem Gjeli	1548		1548
Dures	Kruje	2	Mustafa Kacaci		9 vjecare	Mustafa Kacaci,	247		497
Dures	Kruje					Zenel Tepshi	70		
Dures	Kruje					Myrteza H. Pengili	80		
Dures	Kruje					Arberia	47		
Dures	Kruje					Picrrage	6		
Dures	Kruje					Iliria	47		
Dures	Kruje	2	Ramazan Karaj	SHMB		Ramazan Karaj	224		553
Dures	Kruje					Vesel Brama	62		
Dures	Kruje					Rexhe Deliu	44		
Dures	Kruje					Hajdar Hoxha	169		
Dures	Kruje					Korb Muca	54		
Dures	Kruje	2	Selman Daci	SHMB		Selman Daci	160		
Dures	Kruje					Bakushe Visha	151		515
Dures	Kruje					Sherif Dervishi	55		
Dures	Kruje					Vellezerit Masha	34		
Dures	Kruje					Gjergj Kastrioti	40		
Dures	Kruje					Shaqir Lleja	75		
Dures	Kruje	2	Gjergj Kastrioti Skenderbeu	Gjimnaz		Gjergj Kastrioti Skenderbeu	299		
Dures	Kruje					Hajdar Hoxha	107		489
Dures	Kruje					Gjon Luka	56		
Dures	Kruje					Selman Ali Xaka	27		